



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT PËR VITIN 2022

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 MASHTI në vitin 2022 (duke u bazuar në planifikimin buxhetor) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 1,100,887€ në kategori ekonomike jo adekuate;
- B2 Vlera e prezantuar në PFV për pasuritë kapitale ishte mbivlerësuar për 3,006,470€, si rezultat i mos bartjes së pasurive në regjistrat përkatës të shkollave/komunave pas pranimin të pajisjeve dhe regjistrimit të gabuar (të dyfishtë) të pasurive në SIMKF. Po ashtu, investimet në vijim ishin regjistruar gabimisht si pasuri në përdorim e që kishte ndikuar në aplikimin e zhvlerësimit për projektet në vijim si dhe dy raste kur pasuritë e blera nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria;

MASHTI për periudhën janar-qershor 2022, kishte paguar 68,227€ për 32 punonjës të angazhuar me Marrëveshjen e Brukselit, në mungesë të vijueshmëri në punë. Nga korrik 2022 ministria këtë kategori të të punësuarve i kishte sistemuar në komunat përkatëse duke siguruar hapësira të punës dhe për të njëjtit kishte evidencë të vijueshmërisë në punë. (shih kapitullin 3. çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit).

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek

pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B3 Në 19 pagesa zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimeve dhe pranimit të faturës, ndërsa në shtatë (7) pagesa tjera urdhërblertet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës.
- B4 Në tetë (8) pagesa në vlerë 757,605€ faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor, vonesat ishin nga tre (3) deri në njëmbëdhjetë (11) muaj.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

ZKA është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, ZKA është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi.

Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme

dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2022 ka shpenzuar 85% të buxhetit final ose 69,875,116 €, me një ulje prej 3% në krahasim me vitin 2021. Në kontekst të sistemeve financiare fushat ku janë identifikuar mangësi më të theksuara kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, vonesa në pagesën e faturave, mangësi në procedimin e pagesave, dhe menaxhimin e proceseve të prokurimit. Më tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet në regjistrat kontabël dhe si rezultat i gabimeve si dhe mos harmonizimit vjetor kemi mbivlerësim material të pasurive. Po ashtu, nuk ishin kryer procedurat e bartjes së objekteve arsimore të cilat ishin në përdorim nga Komunitatet përkatëse.

Kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi funksiononin në mënyrë efektive.

Ky raport ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime, prej tyre tri (3) janë rekomandime të reja dhe katër (4) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 5.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18, pikes 3 të Rregullës Financiare nr. 01/2013-Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 I UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

MASHTI në vitin 2022, bazuar në planifikimin buxhetor, ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 1,100,887€⁵ në kategori ekonomike jo adekuate. Këto pagesa ishin kryer nga kategoria e investimeve kapitale, por që për nga vlera individuale e paisjeve dhe natyra e tyre këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Shpenzimet janë si në vijim:

- Shpenzimet për renovimin e sallës së amfiteatrit në Universitetin e Gjilanit në vlerë prej 25,799€;
- Shpenzimet në vlerë prej 52,106€ "Blerjen e veglave muzikore dhe inventar për shkollën e muzikës në Pejë dhe Gjilan";
- Shpenzimet në vlerë 388,239€ për "Furnizim me paisje për salla të sportit në shkolla të arsimit parauniversitar"; dhe
- Shpenzimet në vlerë 634,743€ për "Blerjen e paisjeve për mbrojtjen e objekteve arsimore për qëndrueshmëri dhe blerja e pakove".

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndarjes së mjeteve financiare me Ligj të Buxhetit në kategorinë e investimeve kapitale, pavarësisht kërkesës së MASHTI-t që mjetet për këto projekte të buxhetohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

Rekomandimi B1

Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Mbivlerësimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale

Gjetja

Sipas nenit 13, pikave 1 dhe 2 të rregullores Nr.02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim, kurse neni 3 përcakton që njëri nga kriteret për t'u njohur një pasuri kapitale apo jo kapitale është që pronësia dhe kontrolli i përfitimeve të mbetet te organizatat buxhetore që i mbanë ato.

Po ashtu, neni 11, pika 2 thekson që pasuritë jo financiare kapitale që janë në fazën e investimeve në vijim nuk zhvlerësohen, kurse neni 6, pika 3 thekson që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa ajo jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin "e-pasuria".

Në PFV identifikuam që MASHTI gjatë vitit 2022 kishte mbivlerësuar pasuritë në vlerë 3,006,470€ që kishin të bënin me çështjet në vijim:

- MASHTI paisjet e gatshme të blera për shkollat e ulëta dhe të mesme të komunave të caktuara për mirëmbajtje, pako laboratorike dhe paisjet për sallat e edukatës fizike në vlerë prej 811,008€ i kishte regjistruar në regjistrin kontabël të saj si pasuri, në vend që të bëhej bartja e tyre tek komunat-shkollat përkatëse. Pronësia dhe kontrolli i këtyre pasurive realisht ishte e shkollave, respektivisht komunave përkatëse;
- Nga gabimet në regjistrimin e pasurive kapitale në SIMFK kemi identifikuar mbivlerësim të tyre në vlerë 2,220,754€. Këto gabime ishin kryesisht rezultat i dyfishimit dhe moskujdesit gjatë regjistrimit. Pas identifikimit të gabimeve gjatë procesit të auditimit, MASHTI kishte iniciuar në Thesar kërkesën për korrigjimin e gabimeve në regjistrin e pasurive dhe këto regjistra ishin korrigjuar në maj 2023;
- Pagesat për "Ndërtimin e çerdhes së fëmijëve në lagjen Arbëria në Klinikë" në vlerë 84,049€ dhe për Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në vlerë 86,859€ ishin investime në vijim por gabimisht ishin regjistruar si pasuri në përdorim. Kjo ka shkaktuar zhvlerësimin jo të duhur në vlerë prej 10,798€, duke ndikuar rrjedhimisht në nënvlerësimin e pasurisë; dhe
- Blerjet e 90 radiatorëve për ngrohje qendrore në vlerë prej 5,782€ dhe katër (4) paisje për "Furnizim me printer për ID, ketrigja, WEB cam dhe ID për studenta, në vlerë prej 8,712€" nuk ishin regjistruar në regjistrin e-pasuria në Qendrën e Studentëve.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i volumit të madh të punëve për zyrtarin e pasurisë dhe moskujdesit të duhur në zbatimin e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare nga zyrtarët përgjegjës.

Ndikimi

Regjistrimi i këtyre pasurive nga ana e MASHTI-it dhe mos bartja e tyre në regjistrat e shkollave (komunave) që kanë kontrollin dhe pronësinë si dhe gabimet në regjistrimin e pasurive kanë ndikuar që vlera e pasurive të mbivlerësohet, aplikimi i normës së zhvlerësimit për projektet të cilat janë në vijim si dhe mos regjistrimi i pasurive të blera, ndikon në nënvlerësim të pasurisë kapitale.

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të shqyrtoj mundësinë për rritjen e burimeve për menaxhimin e pasurive dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, barten me të gjitha procedurat formale në regjistrat e komunave. Po ashtu, duhet të korrigjohen të gjitha gabimet e identifikuara në regjistrat kontabël të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B3 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja

Rregulla Financiare nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja dhe pas pranimit të mallit bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura. Kemi identifikuar se:

- Në 19 pagesa ⁷, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimeve dhe pranimit të faturës. Vonesat në zotime ishin nga 14 deri në 194 ditë; dhe
- Në shtatë (7) ⁷ pagesa tjera urdhërblerjet ishin bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit dhe pranimit të faturës. Vonesat në procesim të urdhërblerjes ishin nga katër (4) ditë deri në një (1) vit.

Kjo dukuri ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar procedurat ligjore për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës.

Ndikimi

Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që ministria të mos i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B3

Ministrja duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e plotë të procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave**Gjetja**

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë kërkohet që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Në tetë (8) pagesa në vlerë 757,605€⁸ kemi vërejtur se faturat nuk ishin paguar brenda afatit ligjor.

Këto fatura i takojnë vitit paraprak. Vonesat në pagesën e faturave sillen prej tre (3) deri në njëmbëdhjetë (11) muaj, përtej afatit të përcaktuar ligjor.

Vonesat në pagesën e obligimeve kishin ndodhur për shkak të kontrolleve jo të mira në menaxhimin e obligimeve dhe mungesës së mjeteve për Qendrat e Kompetencës (QeK) sepse ndarja buxheti nuk është i përputhur me nevojat e profileve që kanë QeK dhe janë të obliguara që praktika profesionale të realizohet në bazë të Kurrikulës dhe planit Zhvillimor.

Ndikimi

Vonesat në pagesën e faturave krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues, ku përveç pagesave të faturave Ministria mund të jetë edhe pjesë e padive nga OE si rezultat i vonesave të mëdha në kryerje të obligimeve të saj.

Rekomandimi B4

Ministrja duhet të siguroj një kontroll efektiv të obligimeve që rrjedhin nga aktiviteti i Ministrisë në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar për të shmangur penalizimet për shkak vonesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 20,526,697€, prej tyre ishin shpenzuar 13,562,204€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për ndërtimin e objekteve arsimore, paisjeve të teknologjisë informative, softuer, blerje të inventarit dhe pajisjeve laboratorike, si dhe pajise për salla sportive.

Çështja A1 - Vazhdimi i kontratës pa sigurim të ekzekutimit

Gjetja Neni 30.06 i RRUOPP -së thekson "Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pas kompletimit të kontratës.

Kohëzgjatja për përmbushjen e kontratës për "Ndërtimin e shkollës fillore në Krushë të Madhe, Rahovec" ishte vazhduar për 13 muaj nga kontrata bazë (nga 20.11.2022 deri më 30.12.2023), për shkak që OE kishte dështuar në realizimin e kontratës si pasojë e pandemisë Covid 19. Ne identifikuar që në momentin e vazhimit të kontratës nuk ishte kërkuar që të vazhdohet edhe siguria e ekzekutimit, e cila duhej të kishte afat mbulueshmërie deri në 30 ditë pas skadimit të kontratës. Pas identifikimit nga ekipi i auditimit të kësaj mangësie MASHTI kishte intervenuar duke pranuar sigurimin e ekzekutimit me një vonesë prej katër (4) muajve nga koha që ishte vazhduar kontrata. Pra kjo kontratë ishte për katër (4) muaj pa siguri të ekzekutimit.

Kjo ka ardhur si pasojë e pakujdesisë së zyrtareve përgjegjës për sigurimin e këtij dokumenti, në rastin e aprovimit për zgjatje të afatit të kontratës.

Ndikimi Vazhdimi i kontratës pa sigurim të ekzekutimit rrit rrezikun që në rast të mospërmbushjes së plotë apo shkëputjes së njëanshme të kontratës nga OE, autoriteti kontraktues të mos mund të realizoj kompensimet për dëmet materiale të shkaktuara.

Rekomandimi A1 Ministrja duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit, rastet kur paraqiten vonesa në realizimin e projekteve dhe aprovohet zgjatja e afateve për përmbushjen e kontratave, kjo të përcjellet edhe me sigurinë e ekzekutimit sipas afateve të reja të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 139,503,566€, pasurive jokapitale është 3,781,706€, si dhe e stoqeve 929,080€.

Çështja A2 - Mos bartja e shkollave të ndërtuara tek komunitat përkatëse

Gjetja

Sipas nenit 13, pikes 1 dhe 2 të rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, të gjitha transaksionet e krijuara gjatë ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim dhe në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbylle llogarinë e investimeve në vijim.

Ne identifikuam se në regjistrin e pasurisë të MASHTI-it si investime në vijim janë gjashtë (6) shkolla fillore dhe të mesme të paguara dhe përfunduara në vitet paraprake (2014-2021). Këto shkolla, ishin lëshuar në shfrytëzim dhe i plotësonin kriteret për zhvillimin e procedurave për dorëzim te komunitat përkatëse dhe regjistrimin e tyre si objekte në përdorim. Bartja nuk kishte ndodhur dhe ato ende mbahen në regjistrat e MASHTI-it si investime në vijim, (ka pagesa që për këto shkolla janë regjistruar gabimisht si pagesa në përdorim) edhe pse disa prej tyre praktikisht janë që disa vite në përdorim.

Mos transferimi i shkollave nga MASHTI te Komunitat përkatëse për vite me radhë është një dukuri e përhapur, për shkak të vonesave në zhvillimin e procedurave për dorëzimin-bartjen e shkollave te Komunitat.

Vonesat në transferimin e pasurive nga MASHTI te Komunitat përkatëse për vite me radhë është një dukuri dhe neglizhohet zhvillimi i procedurave për dorëzimin-bartjen e shkollave apo edhe pasurive tjera te Komunitat.

Ndikimi

Mos zhvillimi i procedurave për bartjen e objekteve arsimore edhe pas fillimit të përdorimit të tyre për një kohë të gjatë ka efekt negative në menaxhimin e tyre nga organizata që në realitet e ka kontrollin mbi to.

Rekomandimi A2

Ministrja duhet të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një komisioni për të trajtuar të gjitha objektet arsimore të financuara nga Ministria të cilat i kanë plotësuar kushtet për dorëzim- bartje te Komunitat përkatëse. Po ashtu, të bëhen procedurat formale të bartjes dhe në bashkëpunim me Thesarin regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim të kalojë në regjistrat e Komunitave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2021, ishte 1,117,953€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2023.

Çështja A3 - Shpenzime shtesë si rezultat i pagesave me vendime gjyqësore/ përmbarimore

Gjetja

Neni 39.1 i LMFPP nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagesë. Po ashtu, edhe neni 40.1 thekson "Kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrorit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë".

Gjatë vitit 2022 me vendime gjyqësore/përmbarimore ishin ekzekutuar pagesa në vlerë prej 144,594€. Ne analizuam 22 pagesa në vlerë 98,953€ dhe vërejtëm se shpenzimet shtesë në emër të procedurës gjyqësore/përmbarimore ishin 29,316€. Këto pagesa ishin kryesisht për paga jubilarë dhe shujta sipas kontratës kolektive të stafit arsimor të programeve që janë pjesë e Ministrisë.

Mos realizimi i pagesave me kohë nga Ministria dhe procedimi i tyre përmes gjykatave/përmbarimit ka shkaktuar kosto shtesë.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave në afatin e përcaktuar kanë ndikuar që Ministria të jetë subjekt i padisë, duke shkaktuar shpenzime shtesë përmbarimore përtej borxhit kryesor.

Rekomandimi A3

Ministrja duhet të sigurojë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit në mënyrë që të shmangen kostot shtesë si pasojë e pagesave me procedura përmbarimore apo gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit

Gjate auditimit u identifikuan disa çështje që iu komunikuan menaxhmentit dhe u zgjidhen në mënyrë efektive gjatë auditimit aktual. Ato nuk kërkojnë ndonjë veprim të mëtutjeshëm dhe raportohen vetëm me qëllim të dokumentimit të komunikimit në fjalë, veprimeve të ndërmarra dhe rezultateve të tyre. Çështja materiale të cilën ne e kemi identifikuar dhe është përmirësuar gjatë kohës së auditimit.

Çështja 1

Mungesa e evidencës për vijueshmëri në punë

Gjetja

Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L- 199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojtja Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve, përcakton se "Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Në MASHTI, përmes akt-emërimeve janë punësuar 32 pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur "Mbrojtja civile" të cilët marrin paga të rregullta mujore. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët e Ministrisë këta të punësuar nuk kanë pasur hapësira të përcaktuara të punës për periudhën janar-qershor 2022 dhe nuk kanë zhvilluar asnjë aktivitet në Ministri. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për periudhën janar-qershor 2022 ishte 68,227€.

Në raportet e auditimit të viteve paraprake kjo çështje ishte trajtuar në vazhdimësi duke dhënë rekomandime për adresimin e kësaj çështje. Në vitin 2022 MASHTI ka ndërmarrë veprimet e kërkuara dhe çështja është adresuar.

Veprimi i kërkuar

MASHTI të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune përfshirë hapësirat dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, si dhe duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Rezultati

MASHTI në qershor të 2022, për zgjidhjen e këtij problemi kishte arritur marrëveshje me katër (4) komuna për përfshirjen e tyre në hapësirat e komunave për kryerjen e detyrave sipas kontratave. Ne identifikuam se marrëveshja me komunat kishte filluar të zbatohet dhe se nga muaji korrik 2022, për këta të punësuar kishte dëshmi në regjistrat e ardhje/vajtjes dhe raporte për punët e kryera.

4 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Burimet e fondeve	73,086,831	81,893,863	69,875,116	63,934,474	54,198,552
Grante Qeveritare – Buxheti	71,073,055	77,818,749	68,084,878	61,699,055	44,919,060
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	112,958	1,071,703
Të bartura nga viti i kaluar	0	767,439	526,369	413,289	1,104,293
Të hyrat vetanake	2,013,776	2,013,776	522,320	890,698	937,430
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	5,540,373
Donacionet vendore	0	65,028	64,595	105,389	25,568
Donacionet e jashtme	0	1,228,872	676,955	713,085	600,125

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 8,807,032 €. Kjo rritje është rezultat i kërkesës së Ministrisë për blerjen e librave për të gjitha shkollat, si dhe për shkollat në Preshevë.

Në vitin 2022 OB ka shpenzuar 85% të buxhetit final ose 69,875,116 €, me një ulje prej 3% në krahasim me vitin 2021.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	73,086,831	81,893,863	69,875,116	63,934,474	54,198,552
Pagat dhe mëditjet	21,454,100	21,463,211	20,851,630	20,345,560	19,162,565
Mallrat dhe shërbimet	17,289,858	31,255,803	28,161,093	22,554,296	14,490,316
Komunalitë	1,590,459	1,514,695	1,088,348	1,032,583	759,140
Subvencionet dhe transferet	5,005,360	7,133,457	6,211,841	4,585,831	3,977,731
Investimet Kapitale	27,597,054	20,376,697	13,562,204	15,416,203	15,808,800
Rezervat	150,000	150,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 9,111€, kjo rritje ishte me vendim të qeverisë për t'i mbuluar shpenzimet për paga dhe mëditje. Shpenzimi i buxhetit final 97%;
- Buxheti për mallra dhe shërbime ishte rritur për 13,965,945€, kjo rritje kishte të bënte me vendim të Qeverisë, pas kërkesës së MASHTI-it për mjete shtesë për blerjen e librave shkollor për klasat 1-9, si dhe blerjen e librave edhe për luginën e Preshevës. Shpenzimi i buxhetit final ishte 90%;
- Buxheti final për komunalitë ishte zvogëluar për 75,764€. Kjo shumë u zvogëlua sipas kërkesës së MASHTI-it si kursim buxhetor për shpenzimeve komunale. Shpenzimi i nga buxheti final ishte 72%;
- Buxheti për kategorinë e subvencione dhe transfere është rritur për 2,128,097€, nga i cili ishte shpenzuar 87%. Në mos realizimin e buxhetit në tërësi ka ndikuar kthimi i pagesave të bursave të minoriteteve, nxënësve të gjimnazit matematikor si dhe bursat tjera të studentëve për shkak të gabimeve bankare, si dhe mos pagesa komplet e bursave sipas vendimeve; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 7,220,357€, ndërsa shpenzimet krahasuar me buxhetin final ishin 66%. Realizimi i ulët të buxhetit ishte kryesisht si rezultat i ankesave të Operatorëve Ekonomik (OE) gjatë proceseve të tenderimit në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe mos shqyrtimi i ankesave të OE nga OSHP (nga mungesa e Bordit të OSHP), duke dështuar në lidhjen e kontratave që kanë të bëjnë me ndërtimin e çerdheve, objekteve arsimore dhe sallave të edukatës fizike, po ashtu, inflacioni gjatë vitit 2022 i cili ka ngadalësuar realizimin e projekteve të planifikuara.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2022



Të hyrat e realizuara nga MASHTI në 2022 ishin në vlerë 2,736,910€. Ato kanë të bëjnë me participimet, tarifat për akreditim, taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme, etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2022 Pranimet	2021 Pranimet	2020 Pranimet
Totali i të hyrave	3,028,580	3,028,580	2,736,910	2,434,375	1,839,613
Të hyrat jo tatimore	3,028,580	3,028,580	2,699,268	2,414,044	1,748,692
Të hyrat tjera	0	0	37,642	20,331	90,921

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2021 të MASHTI-t ka rezultuar në 11 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2022, shtatë (7) rekomandime ishin zbatuar, ndërsa katër (4) nuk ishin zbatuar, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2021	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministrja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprime të mëtejme në koordinim me Ministrinë e Financave në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.	Pavarësisht kërkesave nga MASHTI për ndarjen e buxhetit në kategorinë adekuate vërehet se kjo nuk kishte ndodhur nga Kuvendi i Kosovës. Edhe gjatë vitit 2022 kemi hasur në raste të keqklasifikimit.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Ministrja duhet të siguroj se të gjitha pasuritë e regjistruara të cilat janë blerë për shkollat përkatëse, të barten në regjistrat e komunave të cilat i kanë nën administrim këto shkolla, si dhe bartja e pronësisë të bëhet me të gjitha procedurat formale. Po ashtu, në bashkëpunim me udhëheqësit e njësive vartëse (programeve) të sigurojë se bëhet prezantimi i saktë i pasurive të tyre në PFV.	Edhe gjatë vitit 2022 kemi hasur në pasuri të cilat nuk janë bartur tek komunat.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Ministrja në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve duhet të sigurojnë se janë ndërmarrë veprimet e duhura për prezantimin e plotë dhe të saktë të pasurive në PFV. Po ashtu, ndryshimet e konstatuara nga inventarizimi duhet të reflektojnë në gjendjen reale të pasurive jokapitale, duke u kujdesur që aplikimi i zhvlerësimit të pasurive është duke ndodhur në mënyrën e duhur.	Janë ndërmarrë veprimet e duhura për adresimin e këtij rekomandimi	I zbatuar
4.	Baza për opinion	Ministrja duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Shih kapitullin 4, për çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit.	I zbatuar
5.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të forcojë kontrollet e brendshme dhe nga zyrtarët përgjegjës të kërkojë zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciimi i shpenzimeve deri në kryerjen përfundimtare të pagesave.	Edhe gjatë vitit 2022 kemi hasur në raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh.	Edhe gjatë vitit 2022 kemi hasur në vonesa në pagesën e faturave më shumë se 30 ditë.	Nuk ka filluar zbatimi

7.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të siguroj që kriteret e vendosur në thirrjen publike të aplikohen në tërësi dhe që kontratat të nënshkruhen vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në thirrjen publike.	Janë ndërmarrë masat e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Ministrja duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave fillon dhe përfundon brenda afateve të përcaktuara, duke mundësuar që punët të fillojnë në kohën e duhur. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shqyrtohen zgjidhjet e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.	Nuk kemi hasur në vonesa të vlerësimeve të proceduarave të prokurimit.	I zbatuar
9.	Investimet kapitale	Ministrja në bashkëpunim me Drejtorin e Qendrës së Studentëve, duhet të sigurojnë që menaxheri i prokurimit kryen analiza të sakta në lidhje me natyrën e prokurimeve që do të zhvillohen dhe përzgjedh procedurat adekuate të prokurimit që mundësojnë realizimin e kontratave.	Nuk kemi hasur në vazhdimin e kontratave kornizë.	I zbatuar
10.	Pasuritë	Ministrja duhet të siguroj se pagesat realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/furnizimeve të kontraktuara. Po ashtu, për shkollat tjera ku janë kryer punë/furnizime sipas kësaj kontrate duhet të realizohen vizita nga Ministria (menaxheri i kontratës) për të siguruar se janë kryer të gjitha furnizimet sipas kontratës.	Gjatë ekzaminimit tonë në dy salla të edukatës fizike, kemi konstatuar që furnizimet dhe montimet ishin në rregull.	I zbatuar
11.	Pasuritë	Ministrja duhet të siguroj se procesi i inventarizimit të përfundoj me kohë, para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, dhe të bëhet krahasimi mes gjendjes së inventarizuar dhe regjistrave të pasurisë.	MASHTI dhe njësitë vartëse kanë filluar dhe përfunduar procesin e inventarizimit me kohë.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Kreshnike Haziri-Bublica, Udhëheqëse e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	<p>SQARIM: UNIVERSITETI I GJILANIT:</p> <p>Konsiderojmë qe investimet janë te natyrës së kapitaleve, pasi investimi qe është bërë ka të bëjë me rritjen e pasurisë se ndërtesës- objektit te UKZ. Pra, nuk kemi të bëjmë me mallra ose shërbime, po me investime afatgjata kapitale.</p> <p>ADMINISTRATA QENDRORE:</p> <p>MASHTI, ne vazhdimësi ka kërkuar ne dokumentet e planifikimit te buxhetit, si: KASH-i 2022 dhe 2023 planifikimin e buxhetit për vitin 2022-2024 dhe 2023-2025 , nga MFPT-ja bartjen e buxhetit nga kategoria e Investimeve Kapitale tek Mallra dhe Shërbimet, mirëpo e njëjta nuk është aprovuar, ndërsa gjetja tek ne në këtë rast adresohet padrejtësisht. Gjatë procesit te auditimit, ne kemi ofruar te gjitha dëshmitë/kërkesat tona te adresuara atje.</p>	<p>Sipas udhëzimit për definimin e projekteve kapitale dhe rregullave të shpenzimeve të parasë publike, kjo pagesë nuk i takon shpenzimit kapital, pasi që artikujt individualisht janë nën 1,000€.</p> <p>Po ashtu, në raport ne kemi trajtuar edhe përpjekjet e MASHTI-it që disa projekte të financohen/buxhetohen te kategoria mallra dhe shërbime, mirëpo fakti që kjo nuk ka ndodhur dhe shpenzimet (keq klasifikimet) janë pjesë e PFV-ve të MASHTI-it, sipas standardeve të auditimit duhet të paraqiten në Raportin e auditimit të OB-së ku ka ndodhur shpenzimi. Po ashtu, kjo çështje do të adresohet edhe në Raportin Vjetor të Buxhetit të Qeverisë. Buxhetit të Qeverisë.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.</p>



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Prosvete, Nauke, Tehnologije i Inovacija - Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

LETËRKONFIRMIM

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2022 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draftraportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministritë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**, për vitin 2022 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- Pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet. Ndarjet buxhetore nuk varen nga MASHTI, për sa i përket kategorizimeve ekonomike, vendimmarrës është MFPT-ja. Megjithatë, këto çështje po ndikojnë në opinionin e Raportit tonë pavarësisht se MASHTI në vazhdimësi (nëpër vite) po kërkon që çështja në fjalë të rregullohet, në mënyrë që këto mos të përsëriten në raportet përfundimtarë të ZAP-it;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Arbërie Nagavci

Ministër e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit



Datë: 22 qershor 2023, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹¹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinion i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Furnizimet ishin bërë për shkollat: Sami Frashëri-Prishtinë; shkolla e muzikës dhe e artit në Gjilan, Iliria-Prishtinë, Emin Duraku-Bajçine, Emin Duraku-Prishtinë (pagesa në vlerë 198,895€), Idriz AJeti-SHtime, Remzi Ademaj-Prizren, Abdullah SHabani-Carralevë, Lasgush Poradeci-Muzeqine, Dëshmorët e Tivarit-Peçan (pagesa në vlerë 198,895€), Aleksandër Xhuvani-Podujevë (pagesa në vlerë 39,779€), Mehmet Gjevori-Prishinë, Skenderbeu-Hogosht (pagesa në vlerë 74,872€), Abdullah Krashnica-Koretin, Emin Duraku-Shtime, shkolla profesionale-Shtime (pagesa në vlerë 119,337€), Gjergj Fishta-Prishtinë, Naim Frashëri-Shtime (pagesa në vlerë 79,558€), Ibrahim Rugova-Podujevë, Skenderbeu- Kaçanik, Iliria-Savrovë, Shtjefën Gjeçovi-Prishtinë, Mitush Kuteli-Prishtinë, Zenel Hajdini-Prishtinë (pagesa në vlerë 238,674€), Hamëz Jashari-Skenderaj, Abedin Rexha-Turicec, Shaban Jashari-Skenderaj, Dëshmorët e Qyqavicës-Qiriz (pagesa në vlerë 159,116€), Pjetër Bogdani-Prishtinë, Lekë Dukagjini, Ulpiana-Lipjan, Dëshmorët e ZHurit-Zhur, Xhavit Ahmeti-Gjilan (pagesa në vlerë 190,884€), Shkollat që ishin furnizuar për sallat e educates fizike: Luigj Gurakuqi-Batllavë, Lidhja e Prizrenit-Suhareke(pagesa në vlerë 50,000€), Mustafa Bakija-Prizren, Lekë Dukagjini-Prizren, Anton Qeta-Skenderaj (pagesa në vlerë 179,337€), Feriz Guri&Vëllezërit Caka-Kaçanik, Besim Rexhepi-Komogllavë, Imri Halili-Grackë(pagesa në vlerë 184,063€).
- ⁶ Mbivlerësim i pasurive në vlerë 3,031,762€, nënvlerësim të pasurive në vlerë 14,494€ nga Qendra e Studentëve, si dhe 10,798€ aplikimi i normës së zhvlerësimit për projektet në vijim. Paisjet e blera për fushat lëndore dhe mirëmbajtje për shkollat në vlerë 397,790€, pako laboratorike në vlerë 49,818€, si dhe paisje për sallat e edukatës fizike në vlerë prej 363,400€.
- ⁷ Zotimet në vlerë 12,253,601€ për: Blerja e librave pagesa në vlerë 2,249,777€, furnizime për zyrë pagesa në vlerë 12,092€, mirëmbajtje të objektit pagesa në vlerë 23,070€, printime të materialeve arsimore pagesa në vlerë 26,330€, furnizime me dezinfektues pagesa në vlerë 116,255€, blerja e librave pagesa në vlerë 741,716€, pagesa për kompjuterë në vlerë 22,605€, pagesa për pelet në vlerë 18,912€, furnizime me USB në vlerë 16,500€, blerja e librave pagesa në vlerë 477,291€, mirëmbajtja e shkollave në vlerë 29,147€, furnizime me kompjuterë në vlerë 26,250, mirëmbajtja e shkollave në vlerë 29,147€, furnizime me veshmbathje në vlerë 20,775€, furnizim me aksesori dhe materiale mekanike për kabinetet për qendra të kompetencave në vlerë 12,299€, mirëmbajtja e teknologjisë informative në vlerë 5,400€, blerja e librave në vlerë 505,379€, blerja e librave në vlerë 1,256,314€, blerja e librave në vlerë 977,349€, blerja e librave në vlerë 4,040,827€. Vonesat ne UB 756,190€ për: Blerja e peletit në vlerë 5,000€, furnizime për zyre 15,512€, pagesa për SMU në vlerë 5,125€, paisje tjera në vlerë 22,374€, projekti "gjuha shqipe dhe kompjuteri" pagesa në vlerë 277,493€, projekti "gjuha shqipe dhe kompjuteri" pagesa në vlerë 162,900€, projekti "gjuha shqipe dhe kompjuteri" pagesa në vlerë 267,787€
- ⁸ Projekti "gjuha shqipe dhe kompjuteri" pagesa në vlerë 277,493€, projekti "gjuha shqipe dhe kompjuteri" pagesa në vlerë 162,900€, projekti "gjuha shqipe dhe kompjuteri" pagesa në vlerë 267,787€, furnizime për zyrë pagesa në vlerë 3,476€, uniforma për nxënës pagesa në vlerë 31,375€, paisje tjera pagesa në vlerë 11,982€, furnizim me derivate për ngrohje pagesa në vlerë 12,503€, dreka zyrtare në vlerë 89€.
- ⁹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.